



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6534 Prot.

Roskovec, më 01, 10 2021

VENDIM

NR 74. DATË 30.09.2021

**"PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN GUSHT 2021"**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si  
dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 23.08.2021, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Gusht 2021.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Kadri Hyska





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ROSKOVEC**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Adresa: Qendër Roskovec, Web: [www.bashkiaroskovec.gov.al](http://www.bashkiaroskovec.gov.al)

Nr. S730 Prot.

Roskovec, më 24.08.2021

**Procesverbal Nr.9**

-I mbajtur sot, date **23.08.2021, ora 11**, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Korrik 2021.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Korrik 2021.
5. Për dhënien e titullit “ Qytetar nderi”.
6. Për anulim të Vendimit Nr. 17 datë 19.02.2019 “Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për kryerjen e procedurave të lidhjes së kontratës së shit-blerjes”.
7. Për një ndryshim në Vendimin Nr.88 datë 02.12.2020 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2021”.
8. Për miratim dhe transferim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2021.
9. Për miratimin e listes së përfituesve nga “Projekti i përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”.
10. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: **11<sup>05</sup>**

Keshilltaret prezent:A.Kola,V.Mata,E.Çepele,L.Hoxha,L.Goga,B.Çobo,B.Kuka,D.Hoxha,K.Hyska,A.Hazizi,A.Sheme,H.Beqiraj,B.Toska.

Keshilltaret qe mungojne :Rapi Hazizi,Tajane Kuka,Genci Hoxha,Vjollca Bakaj,Vera Dogani,Valbona Stani,Mateus Sufka.

Prezent nga bashkia:Kryetarja e bashkise,Dr.Ekonomike,P/Dr.Juridike,P/Dr.Ardhurave Vendore,P/Z/Ndihmes Ekonomike.

Me plotesimin e kuorumi, kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 13 keshilltare.Kryetari fillon me mbledhjen,e cila do te jepet live ne facebookun e keshillit.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites se sotme dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Korrik 2021.

Sekretarja e Keshillit sqaron informacionin.Sqaron ne lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar.Thekson se nuk kishte vendime normative.Te gjitha vendimet u jane shperndare zyrate.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se Korrikut dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

4.Per dhenien e Ndihames Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Korrik 2021.

Elmazi-per ndihmat e 6% shohim gjithmone te njejtet emra,nuk ndryshohen emrat,a ka ardhur ndonje rregullore nga Ministria per familjet e tjera qe ne e dime qe nuk jane ne pune dhe nuk kane te ardhura.Enkeleda Kola Sp/Z/NE jep sqarimet ligjore per kete pyetje.Dorinela-cilat jane kriteret qe duhet te plotesojne?Enkeleda-pergjigja qe del nga sistemi qe nuk ka marr piket e mjaftueshme,favorizojme nenat kryefamiljare.Elmazi-ne zyren tuaj jane paraqitur nena kryefamiljare dhe nuk perfitojne?Enkeleda-po ka,por nuk jane ne rregull me zyren e punes.Bujari-shoh Njesite Kuman dhe Kurjan qe gjithe kohen ka nga nje familje,ka te tjere?Enkeleda-ka por nuk kane plotesuar kushtet.Hidhet ne votim projekti-vendimi sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

5.Per dhenien e Titullit “Qytetar Nderi”.

P/Dr.Juridike Drinalda Fejzulla sqaron projektin e dhenies se titullit ‘Qytetar Nderi’ z.Gramoz Ruci dhe z.Rrap Plaka sipas motivacionit te paraqitur ne material nga zyra.Leksi-Per Rrap Plaken pyet ne lidhje me Brezen e 2 sulmuese,per z.Gramoz Ruci ne e njohim te gjithe kontributin qe ai ka dhene per zonen tone,duheshin shkruar edhe 2 apo 3 kontribute te tjera per z.Ruci,sepse ai ka shume kontribute ne zonen tone,i ka dhene shume kesaj zone.Kryetarja-degjova pak,ndoshta materjali kishte nevoje per plotesim,e para ne 2015 kur u be reforma territoriale ne Shqiperi,Roskoveci ka qen ne variantin per tu bashkuar me Patosin,nje nga personat qe mua me ka mbeshtetur fuqishem ne punen qe une kam bere qe Roskoveci te ngelej Bashki me vete eshte z.Gramoz Ruci.E dyta-Roskoveci ne keto 6 vite ka perfituar investime goxha madhore,3 nga ato rruga e Arapanit,rruga e Kurjanit dhe per godinen e bashkise kam pasur mbeshtetje te fuqishme per keto nga z.Ruci.Ky propozim eshte per ti dhene nje vlersim edhe me rastin e 70 vjetorit.Bujari-pyet per z.Rrap Plaka i cili u propozua mbledhjen e pare.Kryetarja sqaron se ne prisnim pergjigje nga Institucioni per figuren e tij,e cila erdhi pas mbledhjes se keshillit.Nga interpretimi juridik doli qe figura e tij ishte e paster,pozitive,e cila u be pas mbledhjes dhe prandaj ua sollem sot per formalizimin e gjithe procedures.Hidhet ne votim dhenia e titullit “Qytetar Nderi ”z.Gramoz Ruci dhe z.Rrap Plaka sipas motivacioneve perkates dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro titulli “Qytetar Nderi” i Bashkise Roskovec.Per secilin prej tyre do te zbardhet vendim me vete.

6.Per anulim te Vendimit Nr.17 date 19.02.2019 “Per autorizimin e Kryetarit te Bashkise Roskovec per kryerjen e procedurave te lidhjes se kontrates se shit-blerjes”.

P/Dr.Juridike Drinalda Fejzullah sqaron projektin.Eshte mbledhur njesia per gjegjese per kryerjen e procedurave administrative dhe rezulton se Vendimi Nr.17 date 19.02.2019 eshte ose bie ne kundershtim me ligjin material per shpronesimet.Kryetarja sqaron ne lidhje me projektin se ne konstatuam se menyra e ndjekur nga ne per kete vendim,nuk ishte e duhura ligjore,ne nuk na lejohet te blejme toke per interes publik,por vetem me proceduren e shpronesimit.Prandaj sot kemi sjelle anulimin e atij vendimi dhe te fillojme proceduren e shpronesimit per te njejten objekt,eshte procedura e duhur ligjore.Leksi-zyra juridike i jep fund gjithkaje me kete vendim?Kryetarja-po i jepet fund,dhe do fillojme procedure e re te shpronesimit per te njejten siperfaqe.Nuk ka me

diskutime.Hidhet ne votim anulimi i Vendimit Nr.17 date 19.02.2019 dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

7.Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.88 date 02.12.2020 “Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2021”.

P/Dr.Taksave Donika Goga sqaron tarifen e hapsires publike me ndryshimet e bera sipas propozimit 150 leke/m<sup>2</sup> muaj Roskoveci dhe 100 leke/m<sup>2</sup> muaj per Njesite Administrative.Kryetarja-behet fjale vetem per ato biznese qe perdonin hapsiren publike.Bujari-per tarifen 60 leke/m<sup>2</sup> sa aplikime ka pasur ne bashki dhe qe kane paguar detyrimet?D.Goga-sqaron pyetjen.Bujari-dua te di nese e kemi marr kete tarife apo jo,se ka pak kontrast ne kete ndryshim.Leksi-ne baze te konsultimeve me bashkite simotra dhe nga degjesa publike,mua kjo rritje me duket shume,propozoj qe ne qytet te jete 120 leke/m<sup>2</sup> dhe per fshatin 80 leke/m<sup>2</sup> muaj duke u nisur edhe nga degjesa me grupet e interesit qe zhvilluam.Kryetarja-Bujari ka te drejte,por duke vene re qe ne qytet e kane shtuar hapsiren e zenies se hapsires publike,prandaj menduam ta sillnim kete propozim,qytetaret duhet te jene njelloj.Kryetarja-e gjykojme te pranueshem propozimin e Leksit.Hidhet ne votim projekti i propozuar nga bashkia sipas tarifave te propozuara nga zyra dhe nuk miratohet me 2 vota pro dhe 11 vota kunder.Hidhet ne votim projekti i propozuar nga Leksi me tarifat e ndryshuara:me 120 leke/m<sup>2</sup> muaj per Roskovecin dhe 80 leke/m<sup>2</sup> muaj per 3 Njesite Administrative dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro tarifa per zenie hapsire publike.

8.Per miratim dhe transferim fondesh ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2021.

Dr.Economise Selman Çepele sqaron materjalin e propozuar sipas pikave me radhe.Financimi i perforsimit te ures auto mbi kolektor Suk 2 sipas ndryshimit te bere,fondi per transport rere bituminoze,fondi per objektin emergjencave civile riparim i rruges se Gogallareve dhe rruges se Stanit fshati Ngjeqar,fondi per objektin rikonstruksion i rruges se Dushkut fshati Kurjan,fondi shtese nga dhurata dhe sponsorizime nga projekti TAP per objektin “Rikonstruksion i kopshtit Nr.1 Roskovec”.Dr.Economise i sqaron me detaje te gjitha ndryshimet si me siper.Leksi-per perforsimin e ures ne Suk 2,ne i kemi kaluar njehere,apo tani eshte bashkimi i tyre ne nje vendim?Mos u kemi rene shume ne qaf emergjencave civile?-pyet Leksi.Dr.Selmani-emergjencat per ate pune jane,keto projekte jane emergjente.Kryetarja sqaron ne lidhje me perforsimin e Ures Suk 2,APP ka ndryshuar ligji i tyre ne lidhje me shtesen e bere,duhet bere bashkimi i te 2 fondevet ne 1 dhe do behet nje procedure e vetme.Pas hyrjes ne fuqi te ketij vendimi ne do te fillojme me uren sa nuk ka ardhur akoma dimri.Per investimet e tjera edhe ato jane te nevojshme dhe emergjente,per 2 rruget e Ngjeqarit ato rrezikojne shkarjen,edhe rruga e Dushkut eshte emergjente per tu bere.Rikonstruksioni i kopeshtit Nr.1 eshte me donacione nga TAP-i.Hidhet ne votim projekt-vendimi sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

9.Per miratimin e listes se perfituresve nga “Projekti i permiresimit te banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara”.

P/Dr.Juridike D.Fejzulla sqaron projektin per permiresimin e banesave ekzistuese per komunitetet e varfera.Kryetarja sqaron projektin-te gjithe emrat qe do te futen per miratim,duhet edhe konfirmimi i pronesise nga ASHK-ja.Ministria ka kriteri per personat perfitures,ne momentin e pare cuam 50 emra,1 emer e hoqi vet Ministria,por nga ai moment jane shtuar kerkesat e qytetareve per kete projekt.Duke u shtuar kerkesat,jemi te detyruar te marrim ne konsiderate kerkesat me ne nevoje,kemi bere edhe verifikime ne terren nga komisioni perkates.Pas ketyre verifikimeve kemi bere listen perfundimtare.Kryetarja lexon emrat e personave qe jane future sipas ndryshimeve dhe verifikimeve te bera nga komisioni.Te gjitha keto erdhen se kerkesat e tyre kane ardhur me

mbrapa,dhe ne kemi konstatuar se ata ishin vertete ne nevoje.Viktori-ta kishim te gjithe ate listen.Bujari-mire eshte ta dim se kush perfiton,se ne do dalim neser ne komunitet dhe do na pyesin neve perfituan apo jo?Aleksander-familjet perfituese qe jane hequr do njoftohen?Kryetarja-po,njoftohen me shkrese.Hidhet ne votim miratimi i listes se perfituesve nga "Projekti i permiresimit te banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara" dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

10.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Borana-ne fshatin Kurjan,lagjja Kuka nuk ka uje.Kryetarja-eshte problem i njojur nga ne dhe do e zgjidhim.Elmazi-falenderon kryetaren per sakrificen e ujitjes se tokave bujqesore,por ne kanalet e bera me beton nuk ka uje.Alketi-portat e kanalit jane te shtremberuara,as hapen as mbyllen.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**



**Kryetar**

**Kadri Hyska**

